

UDC 368.91:368.941.4

Rrustem Qehaja, PhD<sup>542</sup>

**PËRGJEGJËSIA JURIDIKE-CIVILE E SIGURUESIT NË  
MBULIMIN E DISA RREZIQEVE PËRKITAZI ME JETËN DHE  
AKSIDENTET PERSONALE**

**ПРАВНО-ЦИВИЛНА ОДГОВОРНОСТ НА ОСИГУРИТЕЛОТ  
ВО ПОКРИВАЊЕ НА НЕКОЛКУ ОПАСНОСТИ ВО ВРСКА  
СО ЖИВОТОТ И ЛИЧНИТЕ НЕЗГОДИ**

**LEGAL LIABILITY OF THE INSURER IN COVERING RISKS  
RELATED TO LIFE AND PERSONAL ACCIDENTS**

---

**Abstract**

Humans as social beings possess as their most valuable assets their life and health which are constantly threatened by various internal and external factors.

The purpose of this research is to inform the reader about the fact that the constant threat has caused the human society to search for different ways of protecting these fundamental values, amongst which without any doubt life and health are included, which can be insured by paying an insurance premium which enables the exercise of the right of indemnification should the insured case happen in an unsure future.

---

<sup>542</sup> Professor of Civil Procedural Law and Insurance Law at University of Prishtina. PhD, Legal – Civil Department PU “Hasan Prishtina” – Prishtinë, Str: Agim Ramadani n.n. Pristina-KOSOVË e-mail: [rrustem.qehaja@uni-pr.edu](mailto:rrustem.qehaja@uni-pr.edu)

The methods used in this study encompass historical, analytical, empirical and comparative approaches with the intention to treat the subject matter from the legal-civil aspect of insurance related to life and personal accidents.

The expected results consist on making the reader aware of the type of coverage offered by insurance of this nature and potential exclusions since these confusions give rise to legal cases between parties.

Hence, the intention is to achieve the conclusion that life assurance and personal accident insurance consist of rights and obligations of the parties which bear legal consequences.

**Key words:** case, policy, insurance, prime and accident.

### Abstrakt

Njeriu si genie shoqërore ndër vlerat më të çmuara ka jetën dhe shëndetin e tij të cilat janë të rrezikuara në vazhdimësi nga faktor te ndryshëm përfshirë ata të brendshëm dhe të jashtëm.

Qëllimi i këtij kërkimi konsiston me njohjen e lexuesit që kanosja ndaj rreziqeve të ndryshme ka nxitur që shoqëria njerëzore të hulumtojë format e ndryshme të mbrojtjes së vlerave fundamentale të njeriut në mesin e të cilave pa dyshim që bënë pjesë edhe jeta dhe shëndeti i tij dhe atë përmes mbulesës së sigurimit të këtyre të mirave kundrejt pagesës së një primi të sigurimit me qëllim të realizimit të së drejtës së dëmshpërblimit në rast të ndodhjes së rastit të siguruar i cili paraqet një ngjarje të ardhshme dhe të pasigurt.

Metodat që përshkojnë këtë punim janë të natyrës historike, analitike, empirike dhe krahasuese objekt i së cilës është trajtimi nga aspekti juridik-civil i llojeve të sigurimit që ndërlidhën me jetën dhe aksidentet personale.

Rezultatet e pritura konsistojnë që lexuesi të jetë në gjendje të kuptoj çka ofrohet me mbulesën e sigurimit të këtij lloji dhe

përrjashtimet eventuale sepse këto paqartësi sjellin kontestin në mes të palëve kontraktuese.

Prandaj, mbi bazën e kësaj mëtohet të arrihet në përfundim se trajtimi i sigurimit të jetës dhe sigurimit nga aksidentet personale ngërthen të drejta dhe detyrime të palëve me pasoja juridike.

Fjalët kyçe: rast i siguruar, policë e sigurimit, prim i sigurimit, kompani sigurimi.

## 1. Hyrje

Në kuptimin e përgjithshëm fjala sigurim nënkupton besimin në diçka apo mbrojtjen.<sup>543</sup> Vështruar institutin e sigurimeve në aspektin historik në fazën e parë të zhvillimit të historisë së njerëzimit, njeriu është përkujdesur në sigurimin e ekzistencës fizike të tij p.sh. ushqimit, strehimit etj. Shoqëria njerëzore gjatë zhvillimit të saj ka reflektuar lindjen e nevojës edhe për forma të tjera të sigurisë së njerëzve, sidomos nga kanosja e rreziqeve të ndryshme si ato natyrore dhe rreziqeve tjera si në të drejtën e pronësisë atë të shëndetit, të jetës etj.

Në periudhat e hershme sidomos në periudhën e romakëve kanë qenë të njohura format e organizimit përmes “*Collegia*” e cila përbente një trup i cili ka mbuluar shpenzimet e varrimit dhe shpenzimet tjera të ushtarëve të Perandorisë Romake. Anëtarët e kësaj trupe kanë kontribuar me njësi monetare të caktuara apo forma të tjera dhe si kompensim kanë pasur të garantuar që do të përfitojnë në rast të vdekjes.

Gjithashtu ka evidenca edhe mbi format e para të organizimit të sigurimeve në Greqinë antike si dhe në Kinë që para 2500 viteve.

Të gjitha këto forma të organizimit secila prej tyre ka funksionuar në mënyrën e vetë, ndërsa policia e parë sipas evidencave daton që nga shekulli XIII e cila ka qenë police e marinës.

<sup>543</sup> Predrag.Sulejqi “Pravo Osiguranje” Beograd 1997, fq.13

Origjina e sigurimit është aq e hershme sa është vështirë të përcaktohet me saktësi se kur ka lindur ajo.

Lidhur me mbulimin e rreziqeve të cilat mund të kanoseshin në atë kohë përkitazi me lundrimin e flotës ishin gjetur dy mënyra për mënjanimin e rrezikut ku njëra kishte të bënte me krijimin e një ndërmarrje të përbashkët aksionare, ne të cilën një grup investitorësh investonin së bashku në një grup anijesh sipas grup mallrave që transportonin, duke u ndarë midis tyre rrezikun e humbjes dhe ndarjen e fitimit të përbashkët.

Në fazat e hershme të këtij procesi, në qoftë se do të ndodhte rreziku, siguruesit duhej të shitnin disa pasuri të paluajtshme me qëllim që të paguanin çfarë ata i detyroheshin të siguroarit, ky princip vazhdon të zbatohet në Lloyd's të Londrës, ku i njëjti lloj premtimi për të paguar, formon bazat e një kontrate të mëvonshme.

Kur bëhet fjalë për institutin e sigurimeve në përgjithësi është i pa shmangshëm trajtimi i shprehjeve të cilat më së shpeshtë përdoren në industrinë e sigurimeve dhe atë:

Në kuadër të kësaj po veçojmë disa nga këto përkufizime:

**“rasti i siguruar”**, që do të thotë se kur shkaktohet një ngjarje, kjo të pasojë dhënien e të drejtës për të marrë një kompensim sigurimi;

**“sigurim”** do të thotë mbrojtje financiare e blerë kundrejt një rreziku të identifikuar potencial të humbjes financiare dhe i evidencuar me anë të policës së sigurimit;

**“kompani sigurimi”** do të thotë person i angazhuar me sigurimin e shërbimeve të përdoruesve të policave;

**“police e sigurimit”** do të thotë çmimi për mbulesën e siguruese i përcaktuar me policë sigurimi;

**“primë e sigurimit”** do të thotë shumë e paguar nga poseduesi i policës me qëllim të sigurimit;

**“licencë”** do të thotë autorizim me shkrim i lëshuar nga AQBK-ja<sup>544</sup> përkatësisht BQK-ja<sup>545</sup>, për kompaninë e sigurimit apo për një

<sup>544</sup> Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës.

<sup>545</sup> Banka Qendrore e Kosovës.

ndërmjetësues sigurimi që jep të drejtën për tu angazhuar në aktivitete të sigurimit siç është saktësuar me rregullore, rregullat e AQBK-së dhe licencën”.<sup>546</sup>

Krahas shprehjeve të sipërpërmendura me rëndësi me këtë rast është të theksohet se në përgjithësi sigurimet ndahen në sigurim të detyrueshëm dhe vullnetar.

Aktualisht në kuadër të sigurimit të detyrueshëm përmendet sigurimi i përgjegjesisë ndaj palëve të treta apo TPL-ja që nënkupton sigurimin nga auto-përgjegjësia me rastin e shkaktimit të aksidentit të komunikacionit.<sup>547</sup>

Kur është fjala te aksidentet e komunikacionit me këtë rast duhet theksuar se nga studimet e aksidenteve të ndodhura në Shqipëri nga viti 1997 deri në vitin 2004, përplasjet në trafik kanë rezultuar me rreth 585 fatalitete në vitin 1997, kurse në vitin 2004 kjo shifër ka arritur rreth 734 aksidente ku fataliteti siç shihet është rritur.<sup>548</sup>

Krahasuar këtë gjendje me Republikën e Kosovës rezulton se te ne brenda një viti ndodhin më shumë se 14 mijë aksidente. Pjesa më e madhe e këtyre aksidenteve përfundojnë me pasoja të rënda: shkaktohen vetëm më pak ose më shumë, dëme materiale. Përafërsisht në çdo të dhjetin aksident ka edhe dëme jo pasurore (morale). Përafërsisht 155 të vdekur dhe afër 2556 të lënduar çdo vit është bilanci i aksidenteve në rrugët e Kosovës. Sipas disa statistikave çdo motorist çdo dymbëdhjetë vite pëson një dëm nga auto-përgjegjësia. Shumë pak prej tyre i njohin mirë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre sa i përket auto-përgjegjesisë për të mundur të shfrytëzojnë të drejtat e tyre pa pengesa të theksuara.<sup>549</sup>

<sup>546</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2001/25 për licencimin dhe mbikëqyrjen e kompanive të sigurimit...

<sup>547</sup> Rr.ustem Qehaja “Përgjegjësia në aksidentin e komunikacionit”, E drejta nr.1/2004, Prishtinë, Ligji për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, Ligji nr. 04/L-018.

<sup>548</sup> Artur Sulçe dhe Edmond Kazazi “Metodika e llogaritjes së aksidentit rrugor” Tiranë, f. 2.

<sup>549</sup> [www.sigkos.com](http://www.sigkos.com)

Nëse krahasojmë pjesëmarrjen e primit ne dëme për vetëm dy vitet e fundit (2012-2013) ne Kosove do vërejmë se vlera e dëmeve te paguara për vitin 2013 paraqet shumën prej 38.7 milion €, krahasuar me 30.7 milion € sa ishte ne vitin 2012, ose rritje për 26.1%.<sup>550</sup> Sipas statistikave numri i dëmeve te paguara gjate vitit 2013 ishte 102.76 dëme, krahasuar me 79.863 sa ishin ne vitin 2012, qe është një rritje prej 28.7 %.<sup>551</sup>

Por, jo vetëm në Shqipëri dhe në Kosovë, por edhe sipas statistikave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, sot në botë numri i personave të vdekur në aksidentet rrugore zënë vendin e tretë në radhën e shkaqeve kryesore që çojnë në vdekjen e parakohshme të njerëzve.

Brenda dhjetë vjetëve sipas parashikimeve të zymta, ndoshta do të kemi postimin në vendin e dytë dhe ndoshta pas njëzet vjetëve në vendin e parë, nëse organizmat dhe strukturat përgjegjëse në këtë fushë si dhe ato qeveritare nuk angazhohen seriozisht për të rritur parametrat e sigurisë në rrugë dhe për të parandaluar aksidentet rrugore.

## 2. Sigurimi i jetës

Jeta paraqet një nga të mirat më të rëndësishme që ka njeriu, por në të njëjtën kohë edhe një nga gjërat më të pasigurta për faktin se asnjëherë nuk është e ditur se sa kohë njeriu do të jetë në jetë, përkatësisht sa vite do jetoj. Meqenëse flasim për diçka të pasigurt atëherë kjo do të thotë se gjërat e tilla është e nevojshme në kuptimin e përgjithshëm të sigurohen. Në kuadër të industrisë së sigurimeve krahas klasave të ndryshme të sigurimit<sup>552</sup> si të detyruar ashtu edhe vullnetar vend me rëndësi zë edhe sigurimi i jetës, andaj është e nevojshme të kemi njohuri për rolin dhe rëndësin e këtij produkti te sigurimeve.

<sup>550</sup> Gazeta e përditshme "Kosova Sot", 07.02.2014, f. 7, Prishtinë 2014.

<sup>551</sup> Vepra e cituar.

<sup>552</sup> Rregulli 2 ne ndryshimin e Rregullit mbi Klasat e Sigurimit të Përgjithshëm të Njohura nga BPK-ja burimi: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

### 2.1. Kuptimi, rëndësia dhe klasifikimi

Në kuptimin e përgjithshëm sigurimi i jetës paraqet një kontratë ku siguruesi i detyrohet të siguroarit t'i bëjë pagesën e shumës së sigurimit nëse ndodhë rasti i siguroar pasi që i siguroari të këtë paguar primin e sigurimit që paraqet momentin e fillimit të dhënies së efekteve juridike të kontratës së sigurimit të jetës.

Pagesa e primit të sigurimit<sup>553</sup> varësisht nga marrëveshja në mes të siguruesit dhe të siguroarit mund të bëhet në një po më shumë këste për periudhën kohore sa zgjatë mbulesa e sigurimit.

Përkitazi me këtë çështje në praktikën e industrisë së sigurimeve është treguar më e rrugës pagesa e primit të gjithmbarshëm, të vetëm se sa pagesa në këste, për faktin se të siguroarit në cilësi të debitorit shpeshherë për shkak të gjendjes jo të mirë financiare nuk përmbushin detyrimet që kanë ndaj të siguroarit dhe kjo gjendje shpien siguruesin që ta anuloj policen e sigurimit dhe të llogarit borxhin e të siguroarit pro rata.<sup>554</sup>

Sigurimi i jetës paraqitet në forma të ndryshme. Kombinimi i tarifave të ndryshme që ofrojnë siguruesit paraqet një ofertë të ndryshme për zgjedhje nga ana e klientëve potencial me qëllim të realizimit të synimeve të tyre.

Sigurimet e të siguroarve zakonisht kanë të bëjnë me mbulesën e sigurimit të jetës në rast të aksidenteve të ndryshme në punë, në shtëpi apo rrugë përkatësisht me rastin e ndodhjes së ngjarjes së ardhme dhe të pasigurt e cila është e mbuluar me sigurim.

Në vendet me traditë sigurimet vullnetare në përgjithësi përfshirë edhe sigurimin e jetës, në portfolien e kompanive të sigurimit kanë rol dominues në krahasim me vendet e rajonit tonë në të cilat në portfolien e përgjithshme të sigurimeve dominon sigurimi nga auto-përgjegjësia (TPL-ja) që në të njëjtën kohë paraqet sigurimin e detyrueshëm.

<sup>553</sup> Lidhur me pagesat e primeve shih: Udhëzimin e BQK-s Nr. 02/2014, per pagesën e primeve të sigurimit përmes sistemit bankar të datës 01.05.2014.

<sup>554</sup> Nga praktika e KS "Sigkos" Prishtinë.

Sigurimi i jetës nga disa autor<sup>555</sup> trajtohet si veprim i mençur i një ekonomisti të mirë të familjes sepse një veprim i tillë edhe pse në shikim të parë duket si shpenzim, ai me kalimin e kohës kthehet në përfitim të shumëfishtë.

Kur trajtojmë sigurimin e jetës atëherë mund të flitet për format e ndryshme të klasifikimit varësisht nga kriteret të cilët merren për bazë dhe atë:

- sigurimin e jetës duke pasur parasysh rrezikun e përfshirë me sigurim,
- sigurimin e jetës duke pasur parasysh mënyrën e lidhjes së kontratës,
- sigurimin e jetës duke pasur parasysh mënyrën e pagesës së shumës së sigurimit,
- sigurimin e jetës duke pasur parasysh numrin e të siguruarve dhe
- sigurimin e jetës duke pasur parasysh ndryshimin e shumës së sigurimit dhe primit të sigurimit.

Në vazhdim do t'i trajtojmë këto forma veç e veç.

*-Sigurimin e jetës duke pasur parasysh rrezikun e përfshirë me sigurim:*

Duke pasur për bazë jetë gjatësinë e njerëzve e cila paraprakisht nuk dihet me saktësi kohëzgjatja e jetës është po kjo, ajo rrethënë e ardhshme e pasigurt e cila përfshihet në sigurim. Ndodhja e rrethanës së ardhshme të pasigurt përbënë rastin e siguruar i cili paraqitet në formë të vdekjes.

Rasti i siguruar në rast të vdekjes paraqitet me vetë ndodhjen e vdekjes të personit të siguruar apo të siguruarit. Varësisht nga kontrata e sigurimit vdekja paraqet rast të siguruar pa marr parasysh se kur ajo ka ndodhur apo vetëm gjatë periudhës së caktuar në kontratën për sigurimin e jetës. Nga kjo buron se kontrata për sigurimin e jetës mund të jetë në formë të sigurimit gjatë tërë jetës apo në formë të sigurimit të kufizuar në periudhë të caktuar kohore e ashtu-kuajtura sigurim i përkohshëm.

<sup>555</sup> Shih: P. Sulejic, vepra e cituar, f. 455.



Nëse bëhet krahasimi në mes të këtyre dy llojeve të kontratave për sigurimin e jetës atëherë mund të konsiderohet se kontrata për sigurimin e jetës në periudhë të pacaktuar kohore është më e favorshme si për të siguruarin ashtu edhe për pasardhësit e tij.

Një formë të veçantë të nën sigurimit të jetës paraqet edhe i ashtuquajturit sigurimi për rastin e përjetimit.

Këtu, rasti i siguruar paraqitet kur i siguruari përjeton ndonjë çast apo ngjarje të caktuar. Siguruesi në këto raste është i detyruar të paguaj shumën e sigurimit nëse me ndodhjen e ngjarjes së parashikuar kohë më parë i siguruari është ende gjallë. Qëllimi i kësaj forme të sigurimit është ko vetëm sigurimi nga pleqëria, por edhe mbrojtja e trashëgimtarëve dhe zakonisht shuma e sigurimit paguhet në formë të rentës.

*-Sigurimi i jetës duke pasur parasysh mënyrën e lidhjes së kontratës.*

Në bazë të këtij kriteri dallojmë lidhjen e kontratës për sigurimin e jetës në aspektin individual dhe atë kolektiv.

Me rastin e lidhjes së kontratës për sigurimin e jetës pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për sigurimin individual apo atë kolektiv në praktikë shumë sigurues paraprakisht rekomandojnë një kontroll mjekësor të klientëve potencial për të pasur një pasqyre të përgjithshme për gjendjen shëndetësore të tyre sepse për çdo lloj tjetër i sigurimit edhe sigurimi i jetës paraqet një marrje të rrezikut mbi supet e siguruesit. Mirëpo, në praktikë nuk përjashtohen edhe rastet kur siguruesi merr në sigurim personat e caktuar pa ndonjë ekzaminim mjekësor paraprak sidomos kur bëhet fjalë për shuma të vogla.<sup>556</sup> Zakonisht siguruesit përkitazi me këtë produkt para se të marrin në sigurim klientëve ju ofrojnë në dispozicion kushtet e përgjithshme që përben edhe detyrim ligjor<sup>557</sup> ku ndër të tjerave parashihet se nëse ndodhë rasti i siguruar (vetëm në rast të vdekjes) pa ekzaminimin mjekësor paraprak në gjashtë mujorin e parë të periudhës së sigurimit

<sup>556</sup> Kjo praktikë është e evidente në Kosovë.

<sup>557</sup> LMD-Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve të Kosovës, Nr. 04/L-077, neni 923.3.

atëherë siguruesi paguan vetëm 50% të shumës së sigurimit në të kundërtën do të paguhet shuma e gjithmbarshme e sigurimit.

*-Sigurimi i jetës duke pasur parasysh mënyrën e pagesës së shumës së sigurimit.*

Parimisht shuma e sigurimit paguhet me rastin e ndodhjes së rastit të siguruar i cili paraqet një rrethanë të ardhshme dhe të pasigurt në vete. Mirëpo, kur ndodhë rasti i siguruar lindë detyrimi i siguruesit që të paguaj shumën e sigurimit. Shuma e sigurimit mund të paguhet në tërësi në forme të rentës së kapitalizuar ose të paguhet në formë të rentës mujore.

Sigurimi i rentës paraqitet në forma të ndryshme duke pasur parasysh periudhën e pagesës, sigurimi i rentës mund të jetë i përjetshëm pra, deri në fund të jetës së të siguarit apo i kufizuar në aspektin kohor. Duke pasur parasysh kohën e arritjes për pagesë apo fillimin e pagesës nga ana e siguruesit ajo mund të jetë e menjëhershme apo të prolongohet kur pagesa e rentës fillon të paguhet më vonë zakonisht në vitet e pleqërisë. Pagesa e rentës për rastet e sipër përmendura mund të kontraktohet në emër të personave të tretë e jo vetëm në emër të siguarit.

Lartësia e rentës mund të jetë e njëjtë gjatë gjithë kohës së pagesës apo edhe të ndryshohet varësisht nga rrethanat e ndryshimit të vlerës së valutës ose ndryshimit të faktorëve të tjerë ekonomik p.sh. inflacioni etj.

*-Sigurimi i jetës duke pasur parasysh numrin e të siguarve.*

Sigurimi i jetës mund të jetë i lidhur me jetën e një apo më shumë personave. Rastet më të shpeshta të sigurimit të jetës janë të dy e më shumë personave p.sh. sigurimi i jetës së dy bashkëshortëve, sigurimi i jetës së ortakëve etj. Me ç'rast me ndodhjen e rastit të siguruar të njërit prej tyre shumën e sigurimit e gëzon tjetri pra, i mbijetuari. Nëse të dy të siguarit përjetojnë mbarimin e periudhës së sigurimit, shuma e sigurimit do u paguhet që të dyve në përpjesëtim të barabartë nëse nuk është parashikuar diçka tjetër në kontratë.

Ky lloj i nën sigurimit të jetës dallon nga sigurimi në rast të vdekjes së personit të siguruar në dobi të personave të caktuar të cilët e mbijetojnë të siguruarin në rastin e dytë siguruesi detyrohet që në rast të vdekjes së personit të caktuar do i paguaj shumën e sigurimit personit të caktuar me kusht që ai në atë moment të jetë në jetë. Për dallim nga sigurimi i më shumë jetëve këtu siguruesi lirohet nga detyrimi nëse shfrytëzuesi vdes para të siguarit.

*-Sigurimi i jetës duke pasur parasysh ndryshimin e shumës së sigurimit dhe primi të sigurimit*

Llojllojshmëria e kombinimit të tarifave për sigurimi e jetës ka për qëllim që sa me më sukses të kombinoj sigurimin dhe kursimin.<sup>558</sup>

Nga kjo mundësohet ndryshimi i shumave të sigurimit të kontraktuar dhe primeve gjatë kohëzgjatjes së periudhës së sigurimit me qëllim të adoptimit të këtyre vlerave ofertave reale të siguruarve nëpërmjet shumës së sigurimit. Në praktikën tonë shumat e sigurimit në rast të vdekjes dhe vonesat të cilat shkaktohen në përmbushjen e detyrimeve dikton zbatimin e kamatëvonesave.<sup>559</sup>

### 2.3. Rreziqet e përjashtuara

Me qëllim që vdekja e një personi (rasti i siguruar) të paraqet bazë për pagesën e shumës së sigurimit duhet të plotësohen kushtet e përgjithshme të cilat janë të nevojshme për kuptimin e rrezikut. Në radhë të parë rasti i siguruar duhet të jetë:

- i paparashikuar se kur dhe a do të ndodhë,
- që rasti i siguruar të jetë i pavarur nga dëshira dhe vullneti i palëve kontraktuese dhe
- rasti i siguruar të jetë shkaktuar konform rendit publik.

Nëse vdekja e një personi plotëson këto kushte atëherë konsiderohet se janë plotësuar kushtet që rasti i siguruar të këtë ndodhur pa marrë parasysh rrethanat të cilat e kanë kushtëzuar përfshirë vdekjen, rastin e aksidentit, pakujdesin e personit të siguruar,

<sup>558</sup> Prirucnik osiguranja cit. nga P. Sulejic, vepra e cituar, f. 458.

<sup>559</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve të Kosovës, Neni 382.

veprimin e personit të tretë etj. pa marrë parasysh vendin se ku ka ndodhur ngjarja, profesionin e të siguruarit etj.

Siguruesi në asnjë rast nuk do të jetë në gjendje të bartë peshën e rrezikut nëse ai është jashtë rrjedhave normale dhe në kundërshtim me metodat e vlerësimeve statistikore.

Të gjitha këto kushtëzojnë që rreziqet e caktuara të vdekjes së të siguruarit të përjashtohen nga i siguruari qoftë nga fuqia e ligjit siç janë rastet e vetëvrasjes dhe vrasjes së qëllimshme të siguruarit nga ana e shfrytëzuesit si dhe rreziqet nga lufta, qoftë nga kushtet e përgjithshme të siguresit të zbatuara në kontratën e sigurimit. Në Kosovë me LMD janë paraparë rastet e përjashtimit të përgjegjësisë së siguresit me rast të vetëvrasjes së të siguruarit,<sup>560</sup> vrasja e qëllimshme e të siguruarit,<sup>561</sup> operacionet luftarake,<sup>562</sup> si dhe mundësia që në kontratën e sigurimit të përjashtohen rastet e tjera të rrezikut nga siguresi.

Rregullat e përgjithshme të sigurimit të jetës nga ana e siguresve zakonisht përjashtojnë këto lloje të rreziqeve:

- kur vdekja e të siguruarit shkaktohet me qëllim të keq nga ana e shfrytëzuesit të sigurimit,

<sup>560</sup> Neni 970 i LMD-së i cili përmban: “Me kontratën mbi sigurimin për rastin e vdekjes nuk është përfshirë rreziku i vetëvrasjes të të siguruarit në qoftë se ka ndodhur në vitin e parë të sigurimit.

Në rastin kur vetëvrasja ka ndodhur brenda tre vjetësh nga data e lidhjes së kontratës siguresi nuk ka për detyrë t’i paguajë shfrytëzuesit shumën e siguruar, por vetëm rezervën matematikore të kontratës”.

<sup>561</sup> Neni 971 i LMD-së “Siguresi lirohet nga detyrimi që shfrytëzuesit t’i paguajë shumën e siguruar, në qoftë se ky e ka shkaktuar me dashje vdekjen e të siguruarit, por ka për detyrë në qoftë se deri atëherë janë paguar të paktën tre primi vjetore, të paguajë rezervën matematikore të kontratës kontraktuesit të sigurimit, e në qoftë se ky është i siguruari atëherë trashëgimtareve të tij”.

<sup>562</sup> Neni 972 i LMD-së i cili përmban: “Në qoftë se vdekja e të siguruarit është shkaktuar në operacionet e luftës siguresi, në qoftë se nuk është kontraktuar diçka tjetër, nuk ka për detyrë t’i paguajë shfrytëzuesit të sigurimit shumën e siguruar, por ka për detyrë t’i paguajë rezervën matematikore nga kontrata.

Në qoftë se nuk është kontraktuar diçka tjetër, siguresi shkarkohet nga detyrimi prej kontratës mbi sigurimin kundër rastit të fatkeqësisë, në qoftë se rasti i fatkeqësisë është shkaktuar nga operacionet e luftës”.

- kur vdekja e të siguruarit është shkaktuar me dënim me vdekje sipas vendimit të plotfuqishëm të gjykatës ose kur i siguruari vritet me rastin e përgatitjes, tentimit apo kryerjes së ndonjë vepre penale për të cilën është parashikuar dënimi me burg të rëndë,

- kur i siguruari bënë vetëvrasje ose vdes në tentim të kryerjes së aktit vetëvrasës në vitin e parë të periudhës së mbulesës së sigurimit të jetës si dhe

- në rastet kur deri te vdekja e të siguruarit vjen për shkak të rrethanave të luftës.

Duke mos hyr në studime më të hollësishme lidhur me përjashtimin e rreziqeve nga sigurimi i jetës duhet theksuar se edhe nëse vështrojmë këtë çështje nga aspekti krahasues do të vërejmë se edhe legjislacionet tjera përmbajnë dispozita të ngjashme. Me këtë rast po theksojmë se vetëm rrethanën e vetëvrasjes si kusht të përjashtimit nga përgjegjësia e siguruesit për sigurimin e jetës së siguruarit e përmban legjislacioni francez, gjerman, italian etj.<sup>563</sup>

Kjo për faktin se vetëvrasja ka natyrë të dyfishtë në industrinë e sigurimit të jetës dhe atë:

- vetëvrasja konsiderohet veprim në kundërshtim me rendin publik, shoqëror dhe moralisht e papranueshme si dhe

- ngjarja e cila paraqet rezultat të veprimit të dështuar d.m.th. mënjanon pavetëdijen si element primar të kuptimit të rrezikut. Sigurimi i rrezikut të tillë konsiderohet i papranueshëm sepse kjo do të thotë marrja e jetës me qëllim të përfitimit përkatësisht realizimit të interesave të caktuar.

#### 2.4. Sigurimi i jetës në dobi të personave të tretë

Sigurimi i jetës është një nga fushat më të rëndësishme të kontratave në dobi të personave të tretë. Të sigurimi në rast të vdekjes siguruari me rastin e shkaktimit të rasti të siguruar detyrohet të paguaj shumën e sigurimit personit të cilit me kontratën e sigurimit paraprakisht është caktuar në cilësi të shfrytëzuesit të sigurimit.

<sup>563</sup> Krahaso: Ligji francez i sigurimeve neni 62, Ligji gjerman i sigurimeve neni 169, KCI neni 1927 etj.

Për dallim nga kjo në disa të drejta ligjrisht është e mundur të lidhet kontrata për sigurimin në dobi të personave të tretë vetëm në rast të vdekjes.<sup>564</sup> Rasti i siguruar mund të realizohet në personalitetin e kontraktuesit ose të ndonjë personi tjetër – të siguruarit. Në të dyja rastet kontraktuesi është në rolin e palës së stipulantit, siguruesi në rolin e palës së promitentit, ndërsa shfrytëzuesi në rolin e palës së beneficiarit nga kontrata në dobi të personave të tretë.

Në praktikë mund të ndodhë që në kontratën e sigurimit të mos jetë i theksuar shfrytëzuesi ose urdhri për përcaktimin e shfrytëzuesit të këtë mbetur pa efekte. Kjo e fundit mund të ndodhë për shkaqe të ndryshme: përcaktimi i shfrytëzuesit mund të jetë i pa qenë apo i anuluar, shfrytëzuesi mund të jetë ftuar ndërsa shfrytëzuesi i ri të mos jetë i caktuar: pas shkaktimit të vdekjes së shfrytëzuesit, para shkaktimit të rastit të siguruar kur shfrytëzuesi refuzon të drejtën e tij etj. Në të gjitha këto raste konsiderohet që kontraktuesi i sigurimit ka lidhur kontratën në dobi të tij e jo në dobi të personit të tretë. Shuma e sigurimit në këto raste i takon pronësisë së kontraktuesit të sigurimit dhe me të drejtat e tjera kalon te trashëgimtarët e tij.<sup>565</sup>

Dallimi themelor sipas kësaj që u theksua më lartë mes të sigurimit të jetës me përcaktimin e shfrytëzuesit të sigurimit dhe sigurimit pa përcaktimin e shfrytëzuesit qëndron në atë se në rastin e parë shumta e sigurimit nuk hynë në përbërje të pronësisë së siguruesit, por i takon shfrytëzuesit i cili mund ti drejtohet me padi indirekte siguruesit, deri sa në rastin e dytë ajo hynë në pronësi të kontraktuesit dhe ndan fatin e pjesës aktive të saj. Nga parimet e tilla burojnë pasojat në vijim:

a) Te sigurimi pa përcaktuar shfrytëzuesin:

<sup>564</sup> Shih fusnotën 1214 të autorit P. Sulejic, vepra e cituar, f. 470.

<sup>565</sup> Neni 985 i LMD-së i cili përmban: “Në qoftë se kontraktuesi i sigurimit për rastin e vdekjes nuk e cakton shfrytëzuesin, apo në qoftë se dispozita mbi caktimin e shfrytëzuesit mbetet pa efekt për shkak të revokimit, apo për shkak të refuzimit të personit të caktuar, ose të cilindo shkak tjetër, ndërsa kontraktuesi i sigurimit nuk cakton shfrytëzues tjetër, shumta e siguruar i takon pasurisë së kontraktuesit të sigurimit dhe si pjesa e saj kalon me të drejtat e tjera të tij në trashëgimtarët e tij”.

-Trashëgimtarët e kontraktuesit në raport me shumën e siguruar nuk paraqiten si shfrytëzues të kontratës në dobi të personave të tretë, dhe nuk kanë të drejtë në padi direkt ndaj siguruesit,

- ata mund të shfrytëzojnë sigurimin vetëm nën kushtet të pranimit të trashëgimisë dhe vetën në lartësi të pjesës së tyre trashëgimore dhe

- kreditorët e kontraktuesit të shumës së sigurimit kanë të drejta të njëjta si në pjesën tjetër të pronësisë së debitorëve.

b) Te sigurimi me përcaktimin e shfrytëzuesit:

- te sigurimi i jetës i cili kontrahohet në dobi të personave të tretë si shfrytëzues i sigurimit realizohen të drejtat në shumën e sigurimit të jetës. Shuma e sigurimit të jetës do të thotë nuk paraqet pasurinë trashëgimore dhe kjo pjesë nuk mund të përdoret për përmbushjen e kërkesave ndaj kreditorëve, por vetëm në dobi të personave të caktuar në cilësi të shfrytëzuesve të sigurimit Kontratat e tilla nuk shërbejnë që me shumën e sigurimit të rritet pasuria trashëgimore e personit të vrarë, por të zhdëmtohen ata që mbijetojnë dhe janë në afërsi të gjinisë në të vrarin apo të vdekurin.

Parimi i njëjtë zbatohet edhe në rastet kur për shfrytëzues janë caktuar trashëgimtarët e kontraktuesit. Ata nuk paraqiten në cilësi të trashëgimtarit dhe shumën e sigurimit nuk kanë të drejtë ta kërkojnë në bazë të trashëgimit, fjala është vetëm për mënyrën e përcaktimit të shfrytëzuesit. Pjesa e sigurimit e cila duhet t'i paguhet shfrytëzuesit nuk bën pjesë në pasurinë trashëgimore të kontraktuesit të sigurimit edhe në rastet kur për shfrytëzues janë caktuar trashëgimtarët e tij.<sup>566</sup>

Kategorisë së këtyre personave sipas kësaj që u theksua më lart, u takon e drejta në pjesën e caktuar të sigurimit dhe nëse heqim dorë nga e drejta në trashëgim. Kur shtrohet çështja e të drejtës së përcaktimit të shfrytëzuesit atëherë duhet theksuar se kjo e drejtë i

<sup>566</sup> Neni 981.1 i LMD-së i cili përmban: "Shuma e siguruar, e cila duhet t'i paguhet shfrytëzuesit nuk hyn në pjesën trashëgimore të kontraktuesit të sigurimit dhe as atëherë kur si shfrytëzues janë caktuar trashëgimtarët e tij".

takon kontraktuesit të sigurimit, kjo për faktin se kjo e drejtë është e drejtë personale dhe ekskluzivisht i takon kontraktuesit të sigurimit.

Por, çështja mund të shtrohet edhe ndryshe se kush mund të jetë shfrytëzues? Atëherë përgjigja do të ishte se shfrytëzues i sigurimit në parim do të mund të ishte secili person i cili ka aftësi juridike dhe të veprimit. Me rastin e përcaktimit të shfrytëzuesit nuk është e domosdoshme prania e tij në momentin e lidhjes së kontratës. Sipas kësaj shfrytëzues mund të jetë edhe personi i përcaktuar në të ardhmen. Me rëndësi është që personi të ekzistojë në momentin e shkaktimit të rastit të siguruar. Nëse shfrytëzuesi vdesë para se të ndodhë rasti i siguruar, Ndërsa në anën tjetër shfrytëzuesi i ri nuk është caktuar akoma atëherë sipas rregullave të disa siguruesve, shuma e sigurimit i takon kontraktuesit të sigurimit përkatësisht trashëgimtarëve të tij. Konsiderohet se shfrytëzuesi fare nuk ka qenë i caktuar dhe dobia nga kontrata nuk u takon trashëgimtarëve të tij por pronësisë së kontraktuesit të sigurimit.

LMD unifikon rastin kur shfrytëzuesi i caktuar vdes para personit të siguruar – të siguruarit me rastin e sigurimit pa përcaktimin e shfrytëzuesit të caktuar.<sup>567</sup>

Në rastet kur shfrytëzuesi është caktuar pa shpërblim, konsiderohet se kontraktuesi ka kontraktuar në dobi të tij, për trashëgimtarët e tij nëse nuk ka shfrytëzues. Shfrytëzuesi i cili ka vdekur në këtë rast konsiderohet sikur të mos ketë ekzistuar fare dhe trashëgimtarët e tij nuk mund të thirrën në të drejtën e sigurimit.

Në rastet kur shfrytëzuesi ka vdekur para se të këtë arritur pagesa e shumës së sigurimit e cila atij do t'i takonte sepse ai në të ka arritur të drejtën në momentin e lidhjes së kontratës.<sup>568</sup>

<sup>567</sup> Neni 984 i LMD-së i cili përmban: “Kur personi i cili pa shpërblim është caktuar si shfrytëzues vdes përpara rrjedhjes për pagesë të krye gjegjëse së siguruar apo të rentës, dobia nga siguri nuk u takon trashëgimtarëve të tij, por shfrytëzuesit pasardhës, e në qoftë se ky nuk është caktuar, atëherë pasurisë së kontraktuesit të sigurimit.”

<sup>568</sup> Neni 981.2 i LMD-së i cili përmban: “E drejta në shumën e siguruar i takon vetëm shfrytëzuesit, e pikërisht nga lidhja e kontratës së sigurimit dhe pavarësisht



Sa i përket çështjes së kohës dhe formës së caktimit të shfrytëzuesit kjo mund të caktohet me kontratë, por edhe me punë të tjera juridike përfshirë edhe testamentin. Vështruar aspektin kohorë të përcaktimit të shfrytëzuesit ai mund të caktohet duke filluar nga momenti i lidhjes së kontratës e deri në momentin e shkaktimit të rastit të siguruar. Forma e përcaktimit të shfrytëzuesit normalisht është nëpërmjet policës së sigurimit.

### 3. Sigurimi nga aksidenti personal

Siguruesi dhe i siguruari apo përfaqësuesi i tij në bazë të vullnetit të lirë, të barabartë dhe në bazë të rregullave të parimit të mirebesimit lidhin këtë lloj të sigurimit, që parashihet në bazë të ligjit dhe Kushteve të përgjithshme të sigurimit nga aksidenti personal si dhe Kushteve të veçanta të sigurimit të punëtorëve nga aksidenti personal.

Aksidenti personal konsiderohet çdo ngjarje e papritur dhe e pavarur nga vullneti i të siguarit, e cila duke u shkaktuar nga jashtë, në trupin e të siguarit, që sjellë si pasojë vdekjen e tij, invaliditetin e plotë ose të pjesshëm, paaftësinë kalimtare për punë ose dëmtimin e shëndetit që kërkon ndihmë mjekësore.<sup>569</sup>

Ndihmë mjekësore kërkohet nëse shkaktohet shkelje, ndeshje, goditje me ndonjë send, goditje nga energjia elektrike ose rrëfeja, ose nga rënia, ose nga rrëshqitja, ose nga plagosja me armë, ose helmimi si pasojë e thithjes së gazrave ose të ujërave helmuese, djegieve të shkaktuara nga zjarri, elektriciteti, nga sendet e nxehta, nga lëngjet ose avulli, nga acidet, nga mbytja ose nga zënia e frymës ose nga mbytje në ujë, thyerjes së eshtrave të personit të siguar etj.

---

se si dhe kur është caktuar si shfrytëzues, e pavarësisht nëse ka deklaruar aprovimin e vet përpara ose pas vdekjes së të siguarit, kështu që mund t'i drejtohet direkt siguruesit me kërkesën që t'i paguhet shuma e siguarit”.

<sup>569</sup> A. Alishani “Modelet e kontratave të së drejtës së detyrimeve, të së drejtës së pronësisë industriale, të së drejtës së autorit dhe të drejtave të ngjashme, të së drejtës së trashëgimisë, të së drejtës tregtare, dhe disa kontrata të Pro-Credit Bankës si dhe poliset e sigurimeve të Kompanisë së sigurimeve, Shoqëri Aksionare “ Kosova e Re”, Prishtinë 2006, f. 361

Pasi që me këtë rast përmendem Kushtet e përgjithshme të sigurimit nga aksidentet personale në vazhdim do të trajtojmë përmbajtjen e tyre.

Zakonisht kontrata për sigurimin nga aksidentet personale lidhet për një afat të caktuar 1 (Një) vjeçar me të drejtë vazhdimi pas përfundimit të periudhës së sigurimit, siguruesi nënshkruan Kontrata të sigurimit pasi të këtë studiuar deklaratat me shkrim për gjendjen fizike shëndetësore të siguruarit dhe pasi është paguar primi i sigurimit. Deklarimet e pasakta të qëllimshme të bëra nga i siguruari apo kontraktuesi mund të shërbejnë si shkak për anulimin e kontratës apo për lirimin e Siguruesit nga detyrimi i pagesës së përfitimit.<sup>570</sup> Sipas këtyre kushteve mund të sigurohen personat prej moshës 16-65 vjeç. Personat më të ri se 16 vjeç dhe më të moshuar se 65 vjeç mund të sigurohen sipas Kushteve të veçanta dhe plotësuese.

Mbulimi në sigurim do të pezullohet apo do të bëhet i pavlefshëm në rastet e më poshtme:

- me përfundimin e afatit të përcaktuar në policen e sigurimit,
- kur në mënyrë të njëanshme njëra nga palët kontraktore nuk përmbush detyrimet. Kur përgjegjësia bie mbi Siguruesin, ky detyrohet të kthej primin e paguar në avans për periudhën e mbetur të sigurimit,
- kur njëra nga palët heq dorë nga kontrata e sigurimit,
- kur i siguruari ndërron vendbanimin e tij jashtë shtetit dhe
- me kryerjen e pagesës pas një ngjarje sigurimi e cila konsumon tërë shumën e mbetur të sigurimit.

Siguruesit zakonisht në kushtet e përgjithshme përcaktojnë edhe rastet të cilat mbulohen me këtë lloj të sigurimit dhe atë nuk do të merret në sigurim dhe nuk do të paguhet përfitimet e parashikuara në police për rastet në vijim:

- ndërhyrjet kirurgjike, kontrollet apo kurimet për shkaqe që nuk lidhen me kushtet e polices,
- aktet e kryera me dashje apo të tentuar nga i siguruari,

<sup>570</sup> Shih: Kushtet e përgjithshme Aksidentet personale të KS “Sigkos” Sh.A. Prishtinë.

- dehja, përdorimi i tepruar i psiko-farmaceutikve, përdorimi i drogës apo i narkotikëve të tjerë,
- operacionet luftarake, zhvillimi i kryengritjeve, zhvendosja e tokës, shpërthimet vullkanike, tërmetet,
- shpërthimet e radioaktiviteteve të energjisë bërthamore, pavarësisht nga origjina e shkaktimit të tyre,
- pjesëmarrja e kontraktuesit apo e përfituesit në krime me dashje ndaj të sigurvearit,
- çdo defekt fizik apo çrregullim shëndetësor, apo çdo sëmundje tjetër që nuk hyn në termin “sëmundje kritike”,
- çdo dëmtim që vjen si shkak i vetëvrasjes apo tentativës për vetëvrasje, ose vetëdëmtim i qëllimshëm,
- personat që vuajnë nga alkoolizmi, narkomania, apo sëmundjet mendore apo që kërkojnë përkujdesje të vazhdueshme nga pjesëtarët e tjerë të familjes ose kujdestari,
- sëmundjet kritike para ekzistuese,
- drejtimi i çfarëdo automjeti apo mjeti lundrues nëse i siguruari nuk është pajisur me dokumentin e duhur të aftësisë dhe
- pjesëmarrja në gara të ndryshme sportive apo në ushtrimet stërvitore të garave.

Gjithashtu siguruesit kanë paraparë edhe çështjen e dëmshpërblimit në rast të ndodhjes së ngjarjes që përbën rastin e sigurvearit. I siguruari apo përfituesi për realizimin e kërkesë së dëmshpërblimit i paraqet siguruesit kërkesën me shkrim së bashku me listën e dokumenteve të përcaktuara nga siguruesi në varësi nga ngjarja e sigurimit dhe pasojat e saj mbi të sigurvearin si: formularin e plotësuar të njoftimit për aksidentin, policen e sigurimit, kartelën klinike të të sigurvearit, certifikatën mjekësore, certifikatën e vdekjes dhe skenden e vdekjes të firmosur nga mjeku ligjor, ekspertizën mjekësore, fletëshkrimin në spital dhe koston spitalore, rekomandimet e mjekut për trajtim mjekësor, fatura e shpenzimeve farmaceutike, vërtetimi i shpenzimeve të transportit etj.

Siguruesi është i detyruar të paguaj apo të refuzoj pagesën e dëmshpërblimit brenda 10 ditëve nga data e dhënies së përgjigjes së

ekspertizës së bërë nga eksperti apo grupi i ekspertëve të caktuar nga siguruesi do të thotë brenda 20 ditëve nga paraqitja e plotë dhe e saktë e dokumentacionit prej të sigurvearit.

Gjatë përcaktimit të lartësisë së dëmshpërblimit siguruesi duhet të bëjë edhe një verifikim: të përcaktoj nëse aksidenti personal ka ndodhur gjatë ushtrimit të profesionit të sigurvearit apo gjatë punës në ndonjë profesion tjetër me klasë të rrezikut më të ulët apo më të lartë se ajo për të cilën është bërë polica e sigurimit.

#### 4. Përfundim

Jeta e njeriut dhe shëndeti i tij janë dy vlera të rëndësishme shoqërore të cilave duhet kushtuar kujdes pse jo edhe përmes forma të organizimit aktual duke sigurvearit të njëjtat nga ngjarjet pasojë e të cilave mund të jetë cenimi i këtyre te mirave shumë të dobishme për shoqërinë në përgjithësi.

Aktualisht në mungesë të një *“infrastruktura”* ligjore që për pasojë ka edhe mos organizimin në nivel qendror të formave adekuate të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit që reflekton mungesën e Ligjit të përgjithshëm për sigurime dhe prolongimin e hyrjes në fuqi të ligjit për sigurimet shëndetësore deri vitin e ardhshëm, bëjnë që këto vlera aq të rëndësishme shoqërore t’i nënshtrohen vullnetit të palëve siguruese përkatësisht sigurvearit dhe të sigurvearit të cilët përmes formave të ndryshme përfshirë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të sigurimit në harmoni me dispozitat ligjore të Ligjit për marrëdhëniet e detyrime (LMD-se) të cilat përbejnë një tersi të polices së sigurimit, vejnë në pah shumë parregullsi në trajtimin e rastit të sigurvearit.

Natyrisht që arritja e qëllimeve të mira paraqet një sfidë të madhe për shoqërinë në përgjithësi e veçanërisht për komunitetin juridik, por realizimi i qëllimeve të tilla është i pashmangshëm, ashtu siç është i pashmangshëm edhe rrugëtimi drejtë strukturave të integrimi evropiane.

#### 4. Summary

The human life and health are two important social values that need attention and why not do that through current organisational activities by insuring them from perils that may endanger these very important assets for the whole society.

Currently, lacking the legal “*infrastructure*” which results in non-organisation at central level of appropriate protective measures of life and health, which reflects the absence of an overall inclusive insurance law and the delay of empowering the law on health insurance until next year, make these important social values submit to will of the insurance parties, respectively the insurer and the insured who use a range of methods including terms and conditions of insurance in accordance with legal dispositions of the Law on obligation relationships (LOR) that constitute an insurance policy, bring to light lots of irregularities in handling an insured case.

Of course, the achievement of good intentions presents a challenge for the whole society especially the legal community, but realisation of such intentions is inevitable, same as it is inevitable the road towards European integrations.